

VENDIM
Nr. 453, datë 29.6.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 317, DATË 31.5.2018, TË KËSHILLIT
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR PËRFAQËSUESIT E
AUTORIZUAR TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË
INDUSTRIALE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 195, 198 dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në përmbajtje të rregullores “Për përfaqësuesit e autorizuar të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”, bashkëlidhur vendimit nr. 317, datë 31.5.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Kudo në tekst, fjalët “licencimi”, “të licencohet”, “licencimin”, “licencimit” dhe “licencën” zëvendësohen, përkatësisht, me “certifikimi”, “të certifikohet”, “certifikimin”, “certifikimit” dhe “certifikatën”.

2. Pika 3, e nenit 2, shfuqizohet.

3. Në pikën 10, të nenit 5, fjalët “... komisioni i licencimit ...” zëvendësohen me “... komisioni i vlerësimit ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj